



E enjte, 21 gusht 2014

NJOFTIM

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka shtyrë afatin për dhënien e komenteve në Raportin Konsultativ të Shqyrtimit të Jashtëzakonshëm të Tarifave të Energjisë Elektrike në kuadër të SHTE8.

Fillimisht Raporti është publikuar në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së me 13 gusht 2014 dhe ju është dërguar të gjitha palëve që të japin komentet e tyre në lidhje me kërkesat e kompanive dhe vlerësimet e ZRRE-së deri me 22 gusht 2014 ora 16:00.

ZRRE thekson se me qëllim që të gjitha palët por edhe konsumatorët të kenë më shumë kohë të analizojnë raportin dhe të dërgojnë komentet e tyre në lidhje me të, ka vendosur që të shtyjë afatin e dhënies së komenteve deri të martën me 26 gusht 2014 ora 16:00, në adresën elektronike info@ero-ks.org ose në adresën postare Rr. Dervish Rozhaja nr. 12, 10000 Prishtinë, Kosovë me titull komente në Raportin Konsultativ të Shqyrtimit të Jashtëzakonshëm të Tarifave të Energjisë Elektrike në kuadër të SHTE8.